



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:187938

Datë: 26.04.2024

Numri i dokumentit: 05630496

KF.nr.120/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “Natural Construction” Sh.P.K., me numër fiskal 601036628, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Fatbardh Makolli avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimi , në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor- publik, të mbajtur me datë 12.04.2024, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse avokat Fatbardh Makolli, dhe në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit “Natural Construction” Sh.P.K. me numër fiskal 601036628, si e bazuar.
- II. ANULOHET vendimi nr.340/2020 i datës 16.11.2020, i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës dhe lënda kthehet në RISHQYRTIM DHE RIVENDOSJE tek e paditura.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 30.12.2020, ka iniciuar kontestin tregtar-administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr.340/2020 i datës 16.11.2020. Përfaqësuesi i palës paditëse në seancën e datës 12.04.2024 dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se njëherit e njoftojmë gjykatën se së bashku me ftesën për seancën e sotme e kemi pranuar ekspertizën financiare të ekspertit U.V. të datës 24.02.24 për çka deklarohe mi për momentin nuk kemi as vërejtje si dhe

nuk kemi nevojë për sqarime shtesë por rezervojmë të drejtën që në rast të sqarimeve plotësuese të ekspertit financiar të parashtrijmë pyetje. Lidhur me kundërshtimin e ekspertizës nga e paditura ka theksuar se së pari këtë kundërshtim në raport me ditën e pranimit të ekspertizës financiare është dorëzuar pas 12 ditëve që do të thotë se e njëjta ka mundur të dorëzohet nga e paditura shumë më herët në mënyrë që edhe ne edhe eksperti të kemi mundësi të parashtrimit të kundërshtimeve tona në lidhje me këto kundërshtime. Ka shtuar se aq sa kuptuam nga këto kundërshtimet e paditura përpos kundërshtimeve të dhëna apriori nuk ka paraqitur asnjë risi apo provë dhe dëshmi e cila kishte mbështetur këto kundërshtime, përkundrazi në përshkrimin e dhënë në këto kundërshtime paraqesin kundërshtime të njëjta sikur në procedurën administrative të zhvilluar tek e njëjta. Gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë të aprovojë si të bazuar si dhe vendimin kontestues të paditurës të anulojë ashtu që paditësit ti kthehet shuma prej 24,960.59 euro si dhe shuma në emër të gjobës prej 2,500.00 euro të gjitha këto në kamatë ligjore prej 8% nga dita e pagesë të këtyre shumave e deri në kthimin definitiv. Shpenzimet e procedurës i kërkojnë dhe atë: për taksë në padi 183 euro, pagesën e ekspertizë 300.00 euro, për padi 208 euro, për seancën për secilën 270.40 euro e për dy seanca i bie 540.8 euro.

E paditura, në përgjigjen në padi të datës 15.07.2021 ka deklaruar se i kundërshton në tërësi pretendimet e paraqitura në padi si të pa bazuara në ligj dhe fakte dhe vlerëson se Vendimi i ATK-së nr.340/2020 i datës 16.11.2020 ka mbështetje ligjore dhe faktike dhe është në harmoni të plot me legjislacionin tatimor të aplikueshëm në Republikën e Kosovës, për ç' arsye do të adresohen pretendimet e paditësit dhe të njëjtat do të argumenton për të vërtetuar pabazueshmërin e tyre, së bashku me sqarime shtesë. Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 12.04.2024 për të paditurën nuk ka prezantuar askush, por me parashtresën e datës 11.04.2024 ka njoftuar gjykatën se nuk mundë të prezantoj në këtë seancë dhe ka kërkuar që sipas nenit 38 paragrafi 5 i Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktin Administrativ *“Gjykata mundë të vendos çështjen pa shqyrtim verbal, nëse ka fakte të mjaftueshme dhe kur palët kanë dhënë pëlqimin e tyre në formë të shkruar.* Sa i përket ekspertizës financiare ka deklaruar se të njëjtën e kundërshton në tërësi, meqë e njëjta bazohet vetëm në një anë të medaljes e po ashtu e konsideron si të vetmin dokument burimor e valid të dhënat që shkojnë në favor të paditësit, pa marr parasysh edhe faktet, rrethanat dhe dokumentacionin kontabël në bazë të së cilës ka vendosur meritorisht e paditura ATK, rrjedhimisht duke mos e vlerësuar drejtë dhe saktë lidhur me precizimin zyrtar të ATK-së, meqë bazuar në faktet dhe dëshmitë e ofruara, paditësi nuk ka ofruar prova që ATK-së të i jepet mundësia të vepronte ndryshe nga përcaktimi zyrtar si në kontrolle dhe vendimin ku konstatohen dhe vërtetohen në mënyrë të argumentuar të gjitha të gjeturat e ekzaminimit tatimor

të kryer të paditësi. Tutja ka theksuar se ekspertiza në fjalë la të meta në përlogaritjet për tatimet që kanë qenë objekt kontrolli, meqë eksperti nuk ka marrë bazë konstatimet e ATK-së dhe argumentime për përcaktimin zyrtar lidhur me deponimet në vlerë prej 76,597.45 €, deponimet të cilat sipas paditësit kanë ardhur nga bizneset që janë në emër të pronarit z.B.B., i cili sipas pretendimeve të paditësit ka edhe biznese të tjera më të njëjtin emër të subjektit tatimor në Bosnje, Maqedoni dhe Serbi, të cilat mjete paditësi pretendon se i ka tërhequr në një nga bizneset e tjera dhe i ka deponuar në llogarinë bankare të biznesit në Kosovë, e më pas sipas paditësit padrejtësisht këto deponime i ka trajtuar si qarkullim shtesë, të cilat pretendime ATK vërteton se nuk qëndrojnë, pasi që ka vërtetuar se kontrolli i realizuar tatimor ka qenë i drejtë dhe ka bazë ligjore dhe është bërë konform paragrafit 1,2,3 të nenit 19 të Ligjit 03/L-222 si dhe nenit 30 paragrafi 3.2 të UA nr.15/2010, ka obliguar paditësin me këto deponime me qarkullim dhe tatim shtesë për periudhat e kontrollit në TVSH-ë dhe TAK. Gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj padinë/ankesën si të pabazuar dhe ta lë në fuqi Vendimin nr.340/2020 të datës 16.11.2020 të ATK-së. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor - publik të datës 12.04.2024, ka administruar provat dhe atë: Vendimi kontestues, Certifikatë e regjistrimit nga ARBK, Ankesë e paditësit në ATK, Marrëveshjet për bashkëpunim afarist , Bilancet e suksesit , Llogaritë nga Ziraat Bank dhe dokumentet e biznesit jashtë vendit, Deklaratë nën betim, Gjendja e përgjithshëm e borxheve të paditësit printuar me datë 14.07.2021, Raporti i kontrollit, faturat , Ekspertiza financiare, Komunikimet e dorëzuara nga eksperti, Vendimi shpjegues 01/2015, Përgjigja në padi e datës 15.07.2021, Pasqyra e rrjedhës së parasë dhe Njoftimi/deklarimi i të paditurës i datës 11.04.2024.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ, deklarimeve në padi dhe përgjigje padi, shkresat e lëndës, vendimi kontestues, dhe deklarimit në seancën e shqyrtimit gjyqësor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se e paditura ka caktuar kontroll tek

paditësi, me ç' rast objekti i kontrollit ka qenë TV 01/2017-07/2019, VW 01/2017-07/2019 dhe CM 01/2017-07/2019, ku është konstatuar se ka pasur rritje të hyrave bruto për këtë vit për shkak të deponimeve pa prejardhje në llogari të biznesit, zvogëlim të KMSH-së të mallrave të përdorura për nevoja jo biznesore si rrjedhojë kemi ndryshime edhe në fitim neto. Jo kontestuese mbesin edhe fakte se tatimpaguesi me datë 09.10.2020 ka dorëzuar ankesën në Divizionin e Ankesave pran ATK-së, për të cilën ankesë ATK-ja me datë 16.11.2020 ka sjell vendimin nr.340/2020, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin ka refuzuar ankesën e këtui paditësit, e ndaj të cilin vendim paditësi me padinë e datës 30.12.2020 ka iniciuar këtë kontest tregtar administrativ.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të paditësit të paraqitura në padi, përgjigjes në padi dhe shkresave të lëndës, me aktvendimin KF.nr.120/22 të datës 09.02.2024 duke vendosur sipas propozimit të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit ka caktuar ekspertizë financiare në këtë kontest tregtar administrativ me ekspertin financiar U.V., me detyrat përkatëse si në dispozitiv të aktvendimit të lartcekur, dhe të jep konstatim dhe mendim profesional.

Gjykata e ka pranuar ekspertizën financiare të ekspertit U.V., në tërësi si të besueshme, pasi e njëjta ishte profesionale dhe e argumentuar mirë në raport me detyrat.

Nga mendimi dhe konstatimet e nxjerra të ekspertit financiar në ekspertizën financiare të datës 24.02.2024 në sqarim dhe në shqyrtimin gjyqësor kryesor publik të datës 12.04.2024, nga ana e ekspertit financiar U.V., për detyrat e caktuara për ekspertizë është dhënë mendim profesional ku i njëjti ka konstatuar se: *Pronari i biznesit apo T/P është pronari i paditëses i cili ka edhe biznese jashtë Kosovës, në Maqedoni, Serbi, Bosnje të cilat janë të pavarura nga biznesi në Kosovë. Pronari deponimet e mjeteve të cilat i ka pas jashtë Kosovës për të mbajtur kontinuitetin e punës në Kosovë me ekspertizë financiare kam konstatuar se ka shumë deponime gjë që si shumë totale e deponimeve që e ka vërtetuar ATK është 90,385.92 euro të deponuar gjatë periudhës 2017-2019, me theks të veçantë se kjo shumë është bruto. Me ekspertizë financiare kam arritur që të dëshmojë transaksionet e këtyre mjeteve janë deponuar në Pro Credit Bank nga paditësi dhe gjatë kësaj analize nuk kam arritur të konstatojë nëse janë fitim i njësisë rajonale, pjesë e dividendës rajonale, pjesë e qarkullimit nga njësia rajonale apo janë pjesë e fitimit që dëshmon me pasqyrat e të ardhurave nga njësitë rajonale. Statuti i njësisë rajonale në raport me biznesin në Prishtinë. Këto deponime zyrtarisht janë bërë përmes deponimeve me bankomat të Pro Credit bankës. Të gjitha këto transaksione janë të regjistruara*

në mënyrë kronologjike në evidencë: rrjedhja e parasë në librat e ofruara nga T/P me përshkrim në detaje për çdo deponim. Këto deponime ATK i ka kontestuar. I ka llogaritur si qarkullim shtesë- të hyra, mandej në përgjigjen e fundit nga e paditura deklarohen se mungon dokumentacioni. Me përgjegjësi të plotë si ekspert financiar kam konstatuar se T/P ka të gjithë dokumentacionin që është i kërkuar në përputhje me Ligjin me ATK-në. Theksoj edhe një herë se teknikisht në bankomat se nuk ka qasje më shumë për të bërë përshkrim të deponimeve. Raporti i kontrollit nuk ka dëshmuar me fakte: cilat janë informatat që kanë siguruar për të dhënë vlerësimin dhe llogaritjen e qarkullimit shtesë, nuk ka vërtetuar ku është deklarimi i pa saktë (apo dëshmi- lëshim i deklarimit- sipas T/P), nuk është vërtetuar – nuk është theksuar se cila evidencë i janë ofruar nga T/P. Raporti i kontrollit ka konstatuar se T/P nuk ka ditar të arkës. Me ekspertizë kemi trajtuar këtë thënie sipas dokumentacionit në lëndë nuk ka evidencë-ditarin e arkës. Pasi kam bërë analizimin e dokumentacionit kam biseduar ndaras, fillimisht T/P i cili është shprehur se: unë gjatë kohës të aktivitetit në Kosovë nuk kam pas nevojë për arkë sepse asnjë pagesë nuk e kam paguar me para të gatshme, por të gjitha përmes bankës. Të njëjtën e kam vërtetuar nga gjendja e raportit të bankës se nuk ka pagesa me para të gatshme. Për shpenzimet dhe shpenzimet jo relevante të biznesit ATK i ka trajtuar si shpenzime të pa pranueshme, ka zvogëluar koston e mallrave të shitura, ndërsa pronari për këto shpenzime jo relevante ka deklaruar se nuk janë përdor për biznes, T/P ka dëshmuar se këto pagesa janë bërë akomodim të ekspertëve që ka bashkëpunuar për inspektimin e punëve. Ndërsa për shpenzimet e naftës në periudhën raportuese ka pas ndërprerje të rrymës, kam qenë i detyruar të përdor gjeneratorin. Këto shpenzime janë ekskluzivisht për gjenerator e jo sikur thotë ATK për automobil të pronarit. Pronari nuk posedon automjet në emër të biznesit në Kosovë”. Përfundimisht konstaton se provat materiale konsiderohen si prova të arsyeshme që janë deponime të ligjshme sipas qasjes të lejuar nga BQK si institucion mbikëqyrës dhe në Bankomat nuk mundet me u bë përshkrim i prejardhjes së transaksioneve-teknikisht është e pamundur me bë përshkrim në kophë kur është bërë deponimi, Vlerësoj se nuk ishte dasht me i trajtuar për llogaritje Qarkullim shtesës – ngarekës për TP duke ju referuar Raportit të llogarisë bankare dhe Evidencës së Rrjedhës së parasë gjatë periudhës 2017-2019.

Gjykata pas analizimit dhe vlerësimit të provave materiale, mendimit të ekspertit, edhe përkundër faktit se në këtë çështje është nxjerr prova me ekspertizë financiare, konstaton se ky kontest tregtar administrativ nuk mund të shqyrtohet në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative për shkak se në pikëpamje të fakteve të vërtetuara ekzistojnë kontradikta në akte, gjë që në pikat esenciale nuk janë vërtetuar plotësisht, e që nga faktet e

vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike, andaj edhe anulohet vendimi kontestues i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës me seli në Prishtinë dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje, tek e paditura e cila obligohet që të vlerësoj të gjitha provat e trajtuara në këtë kontest gjyqësor, respektivisht duhet të konstatoj se deponimet në llogari nëpërmjet bankomatit a janë qarkullime shtesë- të hyra shtesë, të vërtetoje a ekzistojnë dokumentacione në përputhje me ligjin për ATK, të konstatoj se këto deponime a kanë mbulesë apo nuk kanë prejardhje, nga dokumentacioni dhe provat materiale të vërtetohet se nga kanë ardhur këto mjete a janë pikërisht nga pronari i biznesit. Gjithashtu të dëshmojnë cilat janë informatat që kanë siguruar për të dhënë vlerësimin dhe llogaritjen e qarkullimit shtesë, të vërtetoj ku është deklarimi i pa saktë (apo dëshmi- lëshim i deklarimit-sipas T/P) , se cila evidencë i janë ofruar nga T/P, si ka ardhë në përfundim se shpenzimet e naftës janë për automjetin e paditësit. Të marr për bazë edhe të gjeturat tjera nga ekspertiza financiare.

Prandaj, gjykata vlerëson se në këtë lëndë të kontestit tregtar - administrativ nuk ka mundur të vërtetohet saktë dhe në tërësi gjendja faktike, andaj edhe është vepruar konform nenit 43 par 2 të LKA-së, ku thuhet se : *“Nëse gjykata konstaton se konflikti administrativ nuk mund të shqyrtohet në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative për shkak se në pikëpamje të fakteve të vërtetuara ekzistojnë kontradikta në akte, gjë që në pikat esenciale nuk janë vërtetuar plotësisht, e që nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike, ose konstaton se në procedurën administrative nuk janë respektuar rregullat e procedurës, që do të kishin rëndësi për zgjidhjen e çështjes, gjykata do të anulojë me aktgjykim aktin e kontestuar administrativ. Në një rast të tillë, organi kompetent ka për detyrë të veprojë ashtu si është caktuar në aktgjykim dhe të nxjerrë akt të ri administrativ”*.

Gjykata vendos për çështjen e kontestit tregtar administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në vështrim të nenit 43, paragrafi 1, të LKA-se. Në bazë të këtij parimi, Gjykata e ka të pamundur të vendos në mënyrë meritore në këtë kontest tregtar administrativ për arsye se ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, andaj e aprovon kërkesëpadinë e paditësit, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata bazuar në autorizimet nga neni 43 par.2 të LKA-së e detyron të paditurën, që në ri procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetim të këtij aktgjykimi.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, edhe duke u bazuar në nenin 65, të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Me nenin 81.F par.2 të ligjit Nr.04/L-102 të Udhëzimit Administrativ për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L-222 përcaktohet se: *“Administrata tatimore, doganore ose ndonjë administratë tjetër kompetente do të bart detyrimin e vërtetimit të fakteve të cilat e mbështesin vendimin dhe kundërshtojnë kërkesën e tatimpaguesit”*, ndërsa me nenin 7 paragrafi 1 dhe 3 i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 përcaktohet se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë me të cilat konstatohen faktet e tilla, Gjykata nuk mund ta bazojë vendimin e vet në faktet dhe provat, lidhur me të cilat palëve nuk u është dhënë mundësia që të deklarojnë”*. Nga këto dispozita ligjore gjykata konsideron se përdorimi i mjeteve dhe metodave të provuarit, nënkupton një detyrim për palët dhe respektimin e procedurave ligjore të përcaktuara me ligj.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, Gjykata e ka mbështetur në dispozitë nenit 64 të LKA-së.

Nga sa u tha më lart, gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 43 par.2, dhe 46 par 1 dhe 2, të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.120/22, datë 12.04.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.